



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

C.nr.6609/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm-divizioni civil, me gjyqtarin Hysni Ismaili, në çështjen juridike të paditësit G. Sh., nga P., të cilin e përfaqëson M. I., avokate nga P., Rruga “P. A.”, nr.3, H., kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.”, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim i dëmit, jashtë seancës gjyqësore me datë 30.04.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

Për shkak të heqjes dorë nga kërkesëpadia

REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit G. Sh., nga P., me të cilin ka kërkuar që të **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve “S.”, me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material të pësuar si pasojë e aksidentit të trafikut i cili ka ndodh me datë 02.08.2023:

Dëmi jo material:

- kompensim, në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike.
- kompensim, në emër të frikës së përjetuar.
- kompensim, në emër të zvogëlimit të aktivitetit punues.
- kompensim, në emër të shëmtimit.

Dëmi material:

- kompensim, në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj.
- kompensim, në emër të ushqimit të përforcuar.
- kompensim, në emër të trajtimit fizikal.
- kompensim në emër të shpenzimeve mjekësore.

me kamatë ligjore prej 8%, t’i paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit në dorëzim nën kërcënim të përmbarimit forcërisht, **Si e pabazuar.**

A r s y e t i m

Paditësi G. Sh., përmes të autorizuarës të tij ka ushtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Sigma”, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim i dëmit.

Paditësi, përmes të autorizuarës së tij, me parashtresën e datës 22.04.2024, e ka njoftuar gjykatën se heq dorë nga padia dhe kërkesëpadia, meqenëse me të paditurën ka arritur marrëveshje dhe pala është kompensuar.

Gjykata, pas heqjes dorë nga kërkesëpadia e paditësit, konstatoi se në këtë çështje kontestimore kemi të bëjmë me kërkesë me të cilën palët mund të disponojnë lirshëm, në kuptim të nenit 149 paragrafit 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) – me të cilin përcaktohet se *“paditësi, deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes, heq dorë nga një pjesë e kërkesëpadiës apo nga e gjithë kërkesëpadia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi”* (aktgjykimi në bazë të heqjes dorë) – vendosi pa shqyrtim të mëtejshëm si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.6609/2023 datë 30.04.2024

Gjyqtari
Hysni Ismaili

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh , nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.